



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Elbasan, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**LËNDA:** Dërgim njoftimi për botim në Buletinin e Prokurimit Publik.  
**AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK**

**TIRANË**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË  
SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR  
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan

Drejtuar: **“Viola Green” sh.p.k.** me adresë: Bulevardi Bajram Curri , Qendra ETC, Kati 13/1, Tiranë

**Procedura e prokurimit:** Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: - Loti II: “ Kryerja e shërbimit të pastrimit në disa njësi administrative të Bashkisë Elbasan”-** Marrëveshje Kuadër - me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj, me fond limit **57,390,513** (pesëdhjetë e shtatë milion e treqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e trembëdhjetë) **lekë (pa tvsh)**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan. Ky fond përbën vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër.

**Numri i referencës së procedurës/lotit:** REF-79796-09-13-2023

Publikime të mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

**1. “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” SHPK me Nipt: K91628013D**

Vlera e paraqitur në këtë procedurë është **57,098,582.74** (pesëdhjetë e shtatë milion e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e katër) **lekë** (pa tvsh).

**2. “Viola Green” sh.p.k me Nipt: L51928004K**

Vlera e paraqitur në këtë procedurë është **56,454,641.19** (pesëdhjetë e gjashtëmilion e katërqind e pesëdhjetë e katërmijë e gjashtëqind e dyzet e një pikë nëntëmbëdhjetë) **lekë** (pa tvsh).

### **3. “REJ” sh.p.k me Nipt: J93711608Q**

Vlera e paraqitur në këtë procedurë është **49,006,650.13** (dyzet e nëntëmilion e gjashtëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë pikë trembëdhjetë) **lekë** (pa tvsh).

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

#### **1. “REJ” sh.p.k me Nipt: J93711608Q**

##### **1. Ne dokumentat standarte të tenderit parashikohet shprehimisht:**

*Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 2.2.1 e pikës 2.2 - Kapaciteti ekonomik dhe financiar- të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 2.3.1, 2.3.4, 2.3.5 dhe 2.3.10) të pikës 2.3 -Kapaciteti Teknik- të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.*

**Subjekti juaj ka paraqitur oferte ne te dy lotet dhe bazuar ne parashikimin e sipercituar subjekti juaj nuk i ploteson kriteret teknike ne menyre kumulative.**

Ne nenin 42 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe ne rekomandimin e APP-së nr.6732 prot. datë 21.10.2020 parashikohet:

**Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkojnë operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve.**

Në rekomandimin e APP-së nr.6732 prot. datë 21.10.2020 parashikohet:

**Ne rastin kur nje procedure prokurimi eshte e ndare ne lote, APP rekomandon qe minimalisht kriteret financiare ekonomike dhe kriteret mbi aftesine teknike duhet te plotesohen nga operatoret ekonomike, ne raport me numrin e loteve ku marrin pjese.**

**Ne kete kuptim, nese operatoret ekonomike ofertojne ne me shume se nje lot, atehere ato duhet t'i provojne autoritetit kontraktor se disponojne aftesite teknike dhe gjendjen ekonomike financiare per realizimin e te gjithave objekteve te loteve ku kane marre pjese. Per kete qellim, edhe autoritetet kontraktore duhet te kerkojne ne dokumentet e**

**tenderit qe, ne rast se, nje ofertues konkuron me shume se ne nje lot atehere duhet te disponoje kapacitetet financiare, ekonomike dhe teknike, per realizimin e te gjitha loteve, ku ato kane ofertuar.**

**Oferta juaj s'kualifikohet për arsyet e mësipërme.**

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik "**Viola Green**" sh.p.k. me adresë: Bulevardi Bajram Curri , Qendra ETC, Kati 13/1, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë totale prej **56,454,641.19** (pesëdhjetë e gjashtëmilion e katërqind e pesëdhjetë e katërmijë e gjashtëqind e dyzet e një pikë nëntëmbëdhjetë) **lekë** (pa tvsh), eshte identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve)** brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen kuader.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ  
ZV.KRYETARI  
Aulona Bylykbashi**